

VENDIM
Nr.724, datë 21.5.2008

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 2. Detyrat themelore të kësaj agjencie janë gërmimet arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial, në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i kriterëve dhe respektimi i mbikëqyrjes së gërmimeve, riorganizimi, në aspektin muzeal, të trashëgimisë arkeologjike, si dhe administrimi i pasurimit të fondeve, për ruajtjen e objekteve arkeologjike, të luajtshme.
 3. Struktura dhe organika e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 4. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik drejtohet nga drejtori, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 5. Drejtori i ASHA-së organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 6. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e ASHA-së rregullohen me ligjin nr.7961, 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 7. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore të miratojë statutin e ASHA-së, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
 8. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha